



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6), dhe në pajtim me nenin 6, paragrafi (2) dhe nenin 22, paragrafi (7) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 110/21 dhe 74/24), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

V E N D I M

për kushtet dhe mënyrën e miratimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme

I. Dispozitat e përgjithshme

1. Me këtë vendim, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) përcakton kushtet dhe mënyrën e miratimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme për një bankë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, llojet e instrumenteve për kolateralin e mbështetjes së likuiditetit dhe aktivitetet e Bankës Popullore për menaxhimin e rreziqeve të mbështetjes së likuiditetit të miratuar.

II. Kushtet për miratimin e mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme

2. Mbështetja e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme miratohet për të përmirësuar likuiditetin e një banke, për ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar.

3. Mbështetja e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme mund të përdoret nga bankat që kanë detyrim rezervë të detyrueshëm dhe janë pjesëmarrës në Sistemin e Pagesave Ndërbankare të Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: MIPS).

Mbështetja e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme i jepet një banke e cila, sipas vlerësimit të Bankës Popullore, ka aftësi për pagesë, është e qëndrueshme dhe e cila nuk është në gjendje të sigurojë likuiditet përmes burimeve të tjera, ka plan të aksionit të duhur me masa, të pranuar nga Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore, që do të marrë përsipër të tejkalojë vështirësitë e përkohshme të likuiditetit dhe të ketë kolateralin e duhur.

4. Për qëllime të miratimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme, banka konsiderohet si e aftë për pagesa nëse e plotëson shkallën e mjaftueshmërisë së kapitalit prej të paktën 8% ose nëse për bankën, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të së cilës është më i ulët se 8%, por jo më e ulët se 2%, ka perspektiva të besueshme për rikapitalizimin e saj në bazë të të cilave në mënyrë të arsyeshme mund të pritët që banka të përmbushë raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit prej 8% në afat prej 6 muajsh nga paraqitja e kërkesës.

5. Për qëllime të miratimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme, banka konsiderohet e qëndrueshme nëse modeli i saj i biznesit, vlerësuar sipas profilit të rrezikut të përgjithshëm të përcaktuar të fundit të bankës, mundëson funksionim fitimprurës në terma afatmesëm.

6. Mbështetja e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme është e përkohshme dhe bankat mund ta përdorin në bazë afatshkurtër deri në gjashtë muaj. Pas skadimit të gjashtë

muajve të parë, banka mund të përdorë mbështetjen e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme për maksimum prej gjashtë muajsh të tjerë, kështu kohëzgjatja maksimale e përdorimit të mbështetjes së likuiditetit nga banka është dymbëdhjetë muaj.

Brenda kohëzgjatjes maksimale të përdorimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme nga paragrafi (1) i kësaj pike, mbështetja e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme realizohet nëpërmjet miratimit të kredive të siguruara në afat më të shkurtër, të cilat mund të përdoren në shumë raste, duke vepruar në pajtim me kreun III të këtij vendimi.

7. Mbështetja e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme, me rregull miratohet në denarë.

Me përjashtim të paragrafit (1), nëse banka ka nevojë për financim në valutë të huaj dhe nuk ka mundësi të sigurojë mjete në valutë të huaj përmes tregut të këmbimit valutor, mbështetja e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme mund të miratohet edhe në valutë të huaj, vetëm në euro.

8. Për mbështetjen e likuiditetit të miratuar në rrethana të jashtëzakonshme, pavarësisht valutës në të cilën është miratuar, Banka Popullore tarifton interes sipas normës së interesit që fitohet duke shtuar tre pikë përqindje në normën e interesit për kreditë e njëditore të Bankës Popullore, e cila është e vlefshme në momentin e miratimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme.

III. Mënyra e miratimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme

9. Banka i paraqet kërkesë Këshilli Ekzekutiv të Bankës Popullore për përdorimin e mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme, e cila përmban:

- përshkrim të arsyeve që çuan në nevojën e përdorimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme;
- shumën e nevojitur për mbështetje të likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme;
- vlerësimin e kohës maksimale të nevojshme për të përdorur mbështetjen e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme nga Banka Popullore;
- listë të të gjitha mjeteve në dispozicion të bankës dhe dokumentacionin e duhur për konfirmimin e pronësisë;
- deklaratë nga Këshilli Drejtues se banka ka përdorur më parë të gjitha burimet e tjera të disponueshme të likuiditetit, duke përfshirë mundësinë e financimit nga banka vendase, nëse është e zbatueshme;
- deklaratë nga Këshilli Drejtues se banka nuk ka mundësi të sigurojë mjete në valutë të huaj nëpërmjet tregut valutor, në rastet në pikën 7), paragrafi (2), të këtij vendimi;
- plani i veprimit dhe projeksionet me masat që do të marrë banka për tejkalimin e problemeve të përkohshme të likuiditetit dhe bilanci i parashikuar dhe treguesit për mbikëqyrjen e mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme sipas formularit nr. 1 që është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Në plan duhet të jepet përshkrim/shpjegim i detajuar sipas tremujorëve për mënyrën e tejkalimit të problemeve të likuiditetit, veçanërisht duke marrë parasysh planin e lëvizjes së mjeteve të veta, planin e kreditimit, politikën e dividendit, planet për rritjen e depozitave dhe strategjinë për mbajtjen dhe tërheqjen e depozituesve të rinj dhe politikën për vendosjen dhe mbikëqyrjen e sigurisë dhe
- projeksioni i të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, si dhe i rezultatit financiar për 12 muajt e ardhshëm.

Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore mund të kërkojë nga banka të dhëna të tjera shtesë për të vlerësuar gjendjen e saj financiare.

10. Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore vendos për miratimin ose mosmiratimin e kërkesës për mbështetje likuiditeti në rrethana të jashtëzakonshme. Në rast miratimi, Këshilli Ekzekutiv vendos për lartësinë e shumës së kredisë për mbështetjen e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme që do t'i miratohet bankës, datën e maturimit të kredisë për mbështetjen e likuiditetit dhe instrumentet për sigurimin e mbështetjes së likuiditetit.

Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore miraton vendimin nga paragrafi (1) të kësaj pike, bazuar në vlerësimin e përmbushjes së kushteve nga banka për miratimin e mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme, planin e veprimit me masat e paraqitura nga banka dhe vlerësimin e efekteve të miratimit ose mosmiratimit në stabilitetin e sistemit financiar.

Miratimi i mbështetjes së likuiditetit nga Këshilli Ekzekutiv mund të pasohet nga kushte shtesë për bankën e cila do të përcaktohet nga kontrata për miratimin e mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme nga pika 11) e këtij vendimi.

11. Në mbështetje të vendimit të Këshillit Ekzekutiv nga pika 10) e këtij vendimi, Banka Popullore dhe banka lidhin kontratë për miratimin e mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme (në tekstin e mëposhtëm: Kontrata), me të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

Me Kontratën rregullohen edhe instrumentet e kolateralit që banka duhet të transferojë në favor të Bankës Popullore.

Të gjitha shpenzimet e bëra gjatë procedurës për miratimin dhe ofrimin e mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme dhe gjatë ekzekutimit të saj do të përballohen nga banka.

12. Banka Popullore i paguan mjetet nga mbështetja e likuiditetit të miratuar në rrethana të jashtëzakonshme pasi banka të ketë transferuar instrumentet e sigurisë në favor të Bankës Popullore.

13. Banka është e obliguar t'i dorëzojë Bankës Popullore raportin ditor për rrjedhat e likuiditetit në pajtim me formularin nr. 2 - Formular për mbikëqyrjen e likuiditetit të një banke që përdor mbështetje likuiditeti në rrethana të jashtëzakonshme, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Banka është e detyruar të dorëzojë raportin për përmbushjen e masave të planit të veprimit nga pika 9), paragrafi (1), nënparagrafi (7) i këtij vendimi, së bashku me të dhëna të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve në bazë të Kontratës nga pika 11), t'i dorëzojë të paktën një herë në javë ose më shpesh, me kërkesë të Bankës Popullore.

14. Në rast mospërmbushjeje nga banka të ndonjë prej detyrimeve të përcaktuara nga Kontrata nga pika 11) e këtij vendimi, Banka Popullore ka të drejtë të ndërpresë menjëherë Kontratën dhe të fillojë zbatimin e instrumenteve për sigurimin e kërkesave bazuar në mbështetjen e likuiditetit të aprovuar.

Në ditën e përfundimit të mbështetjes së likuiditetit për arkëtim, të gjitha detyrimet e papaguara që banka ka ose do t'i detyrohet (interesi i pamaturuar deri në ditën e përfundimit) në bazë të asaj marrëveshjeje.

15. Para datës së maturimit të kredisë për mbështetje likuiditeti në rrethana të jashtëzakonshme, banka mund të kërkojë ndryshime në kushtet kontraktuale të kredisë së

miratuar më parë për mbështetjen e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme. Kërkesa i paraqitet Këshillit Ekzekutiv së bashku me dokumentacionin e parashikuar në pikën 9), nëse ka ndryshime në dokumentacionin e paraqitur më parë.

Banka Popullore mund të kërkojë nga banka të dhëna dhe informacione dhe dokumentacion shtesë.

Këshilli Ekzekutiv vendos në bazë të kërkesës së bankës për ndryshime të kushteve kontraktuale të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme.

Për të gjitha ndryshimet në kushtet kontraktuale të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme, Banka Popullore dhe banka lidhin aneks të kontratës.

16. Në datën e maturimit të kredisë për mbështetje të likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme, banka është e detyruar që shumën e miratuar të mbështetjes së likuiditetit t'ia kthejë Bankës Popullore, së bashku me interesin.

Banka mund ta kthejë kredinë për mbështetje të likuiditetit në raste të jashtëzakonshme dhe para afatit të caktuar, për të cilin e njofton me shkrim Bankën Popullore.

17. Nëse në ditën e maturimit ose të përfundimit të mbështetjes së likuiditetit, banka nuk përmbush ose përmbush pjesërisht detyrimet që rrjedhin nga Kontrata nga pika 11) e këtij vendimi dhe anekseve të tij, Banka Popullore llogarit dhe cakton normën gjobë të interesit dhe do të fillojë aktivitetet për ekzekutimin e instrumenteve të sigurimit nga pika 18) e këtij vendimi.

IV. Instrumentet e kolateralit dhe aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të mbështetjes së likuiditetit të miratuar në rrethana të jashtëzakonshme

18. Instrumentet e kolateralit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme të pranuar nga Banka Popullore janë letrat me vlerë të borxhit, valutë të huaj, kërkesat e bankës nga Banka Popullore, kërkesat e bankës nga klientët dhe mjetet tjera që Banka Popullore do t'i konsiderojë të pranueshme.

Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore vlerëson se cilat instrumente do të pranojë për të ofruar mbështetje likuiditeti nga lista e mjeteve nga pika 9), paragrafi (1), nënparagrafi (4) i këtij vendimi.

Vlerësimi i pranueshmërisë së instrumenteve për sigurimin e mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme nga paragrafi (2) i kësaj pike, Këshilli Ekzekutiv e bën atë në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Bankës Popullore me akt të brendshëm.

Afati i maturimit të mbetur të instrumenteve të kolateralit duhet të jetë më i gjatë se maturimi i mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme.

19. Shuma e mbështetjes së likuiditetit të miratuar në rrethana të jashtëzakonshme është më e ulët se vlera e instrumenteve të përdorura për kolateral, në pajtim me vlerësimet e Bankës Popullore për rreziqet që rrjedhin nga mbështetja e miratuar e likuiditetit.

Për kohëzgjatjen e përdorimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme, Banka Popullore mbikëqyr rregullisht vlerën e instrumenteve të kolateralit dhe ka të drejtë të kërkojë mbulim shtesë me para të gatshme dhe/ose instrumente përkatëse të kolateralit.

20. Me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar, në rastet e parapara në

nenin 22, paragrafi (4) të Ligjin e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore mund t'i japë mbështetje likuiditetit bankës në rrethana të jashtëzakonshme në bazë të garancisë së ofruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Garancia nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet t'i referohet shumës së mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme, duke përfshirë interesin për periudhën e përdorimit të mbështetjes së likuiditetit.

V. Dispozita përfundimtare

21. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon së vlefshmi Vendimi i kredisë në instancë të fundit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.74/15).

22. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V. nr. 02-34557/5
9 tetor 2024
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

Формулар бр. 1 - Биланс и парашикун и трегуесит пѐр мбикѐкырјен и мбѐштетјес сѐ ликвидитетит нѐ ррѐћана тѐ јасћѐзаконшме

Проектиран биланс на состојба и показатели за следење на кредитот за ликвидносната поддршка во исклучителни околности						
	Почетна состојба	состојба на крај на месецот кога е поднесено барањето	квартал 1	квартал 2	квартал 3	квартал 4
АКТИВА						
Готовина во благајна						
Парични средства кај НБ (вклучувајќи ги и депозитите кај НБ)						
Хартии од вредност издадени од НБ						
Хартии од вредност издадени или гарантирани од Државата						
со преостаната рочност до 3 месеци						
со преостаната рочност од 3 месеци до 1 година						
со преостаната рочност од 1 до 3 години						
со преостаната рочност од 3 до 10 години						
со преостаната рочност над 10 години						
Хартии од вредност издадени од кој било друг орган на државната власт, јавни претпријатија и јавни установи, трговски друштва основани од Државата или во кои Државата е доминантен сопственик, органите на општините во Државата, општините на Градот Скопје и Градот Скопје						
со преостаната рочност до 3 месеци						
со преостаната рочност од 3 месеци до 1 година						
со преостаната рочност од 1 до 3 години						
со преостаната рочност од 3 до 10 години						
со преостаната рочност над 10 години						
хартии од вредност издадени од други централни влади, јавни институции во други земји, локална самоуправа и регионална власт на други земји, мултилатерални развојни банки и меѓународни организации						
со преостаната рочност до 3 месеци						
со преостаната рочност од 3 месеци до 1 година						
со преостаната рочност од 1 до 3 години						
со преостаната рочност од 3 до 10 години						
со преостаната рочност над 10 години						
Други должнички хартии од вредност, сопственички инструменти и деривативи						
Пласмани во банки						
Кредити на нефинансиски субјекти						
кредити на претпријатија						
кредити на домаќинства						
кредити на останати субјекти						
Побарувања по основ на даноци						
Останати побарувања						
Нематеријални средства						
Материјални средства						
Преземени средства од ненаплатени побарувања						
ПАСИВА						
Депозити на финансиски друштва						
депозити по видување						
краткорочни депозити						
долгорочни депозити						
Депозити на нефинансиски субјекти						
депозити на претпријатија						
депозити на домаќинства						
депозити на останати субјекти						
депозити по видување						
краткорочни депозити						
долгорочни депозити						
осигурени депозити						
неосигурени депозити						
Обврски по кредити						
покриени кредити						
непокриени кредити						
Издадени должнички инструменти						
Субординирани и хибридни инструменти						
Обврски по основ на даноци						
Деривативи и останати финансиски обврски						
Посебна и резерва и останати резервирања						
Капитал и резерви						
Потреба од финансирање од НБ						
обврски кон НБ по основ на инструментите на монетарна политика						
кредит за ликвидносната поддршка во исклучителни околности (ELA)						
Расположлив колатерал по примена на коефициентите на покрите (haircuts)						
обврски кон НБ по основ на инструментите на монетарна политика						
кредит за ликвидносната поддршка во исклучителни околности (ELA)						
Обврска за ЗР (reserve requirement)						
Потреба од финансирање од НБ (% вкупна актива)						
обврски кон НБ по основ на инструментите на монетарна политика (% од вкупна актива)						
кредит в за ликвидносната поддршка во исклучителни околности (ELA) (% од вкупна актива)						
Вкупна висококвалитетна ликвидна актива (ВКЛА)						
Актива пондерирана според ризици (АПР)						
Стапка на адекватност (САК)						
Стапка на покриеност со ликвидност						

Formulari nr. 2 - Formulari për mbikëqyrjen e likuiditetit të një banke që përdor mbështetje likuiditeti në rrethana të jashtëzakonshme

Образец за следење на ликвидноста на банка која користи ликвидносна поддршка во исклучителни околности											
				Позиции во билансот на банката кои достасуваат во следните 30 дена							
				кредити							
				датум на достасување		износ		назив на клиент		каматна стапка	
				Вкупно							